



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4291 / Prot
2

Gramsh, më 17.11.2021

VENDIM

Nr. 116 datë 17.11.2021

**“PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRVENDORE
PËR KRIJIMIN E NJË PERSONI JURIDIK TË PËRBASHKËT”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.6(b), nenit 14, pika 3 e 5, nenit 23, pika 10, nenit 33, pika 1(d) dhe nenit 54, gërma (gj) të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Gramsh, duke vlerësuar nevojën që nëpërmjet aktivitetit të ushtruar nga një person juridik i pavarur, i përbashkët me të gjitha njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore të qarkut Elbasan, të përmbushë funksionin dhe shërbimin vendor për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, në kushtet kur nuk vlerësohet efçente asnjë mënyrë tjetër për ushtrimin e këtij funksioni, në mbledhjen e tij të datës .11.2021, pasi mori në shqyrtim propozimin e Kryetarit të Bashkisë Gramsh,

VENDOSI

1. Të miratojë krijimin e një personi juridik të përbashkët, që do tu shërbejë të gjitha njësite bazë të vetëqeverisjes vendore të qarkut Elbasan për ushtrimin e funksionit të mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
2. Të miratojë marrëveshjen ndërvendore midis shtatë bashkive të qarkut Elbasan për krijimin e një personi juridik të përbashkët në formën e një shoqërie tregtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I BASHKISË GRAMSH
KRYETAR
Greta LENA

Konc.Dakt: Xh.Gjini
Pranoi: G.Lena
Miratoi: G.Lena
Dosja _____